



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39 dhe 40 të Ligjit mbi tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 14/80 dhe 42/86), nenit 3, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më, 31.10.2003 merr

V E N D I M
MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR DISLOKIMIN
E TREGUT TË GJELBËR ME SHUMICË TË
QYTETIT TË PRISHTINËS

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për dislokimin e Tregut të gjelbër me shumicë të qytetit të Prishtinës nr. 01-353-2916 dt. 12.12.2001.

Neni 2

Neni 1 i Vendimit mbi caktimin e lokacionit për dislokimin e Tregut të gjelbër me shumicë të qytetit të Prishtinës nr. 01-353-2916 dt. 12.12.2001, ndryshohet dhe bëhet:

“Lokacioni për dislokimin e Tregut të gjelbër me shumicë të qytetit të Prishtinës, caktohet në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 1197, KK Bërrnicë e Ulët, me sipërfaqe prej afro 10 ha.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi dhe aplikohet ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.353-1919 Dt. 06.11.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri